

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 7526 Rep.

Nr. 1638 Kol.



AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK

Ne Tirane, sot me date 28 Nentor 2007, perpara meje noteres Mojlinda Zeri, anetare e dhomes se notereve Tirane, u paraqiten personalisht,

1) Shoqeria “Biopower Consulting” shpk.; me kod fiskal me nr. regjistrimi : 05687540968, ne regjistrin e shoqerive te Milanos, data e krijimit 20/02/2007, themeluar me aktin e dates 31.01.2007, Forma juridike: shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, seli ne Milano, Viale Coni Zugna, 71 CAP 20100, jetegjatesia e shoqerise, data perfundimtare 31.12.2050, perfaqesuar sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise nga **Dr. Giuseppe LAGROTTA**, lindur ne Potenza, me date 14.04.1973, banues ne Bari, Itali ne Via de Gasperi 292/D- shtetas italian, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. AK 3684417,

2) Shoqeria “Ital Green Engineering” shpk.; - me kod fiskal me nr. regjistrimi : 02051080741, ne regjistrin e shoqerive te Brindizit, data e krijimit: 27.04.2004, themeluar me aktin e dates 29.03.2004, Forma juridike: shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, Selia: Ostuni (BR), Localita' Marina Di Ostuni cap 72017, C/O Grand Hotel, jetegjatesia e shoqerise, data perfundimtare: 31.12.2050, perfaqesuar sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve te shoqerise nga **Dr. Giuseppe LAGROTTA**, lindur ne Potenza, me date 14.04.1973, banues ne Bari, Itali ne Via de Gasperi 292/D- shtetas italian, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. AK 3684417,

3) Hastri & Sojli, lindur me 25.11.1942, ne Tirane, Shqiperi, banues ne Monopoli, in Via fume N.42-70043 Bari-C.F. madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. AM 2553411.

te cilet me cilesine e “ Ortakeve Themelues “, me kerkuan redaktimin e ketij akti themelimi, nepemjet te cilit ata deklaruan se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 7638 date 19.11.1992, “ Per shoqerite tregtare “, ne ligjin “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin “BIOPOWER GREEN ENERGY “ shpk

KREUI

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "BIOPOWER GREEN ENERGY" SHPK.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "BIOPOWER GREEN ENERGY" shpk, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "BIOPOWER GREEN ENERGY" shpk, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët të cilët përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Qendra e Biznesit Zayed, Rr. Sulejman Delvina.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike dhe termike nga burime energjitike konvencionale të një natyre të ngurte, të lenget apo të gazte me të gjitha teknologjitë e mundura;

Prodhim dhe shitje të energjisë elektrike dhe termike nga burime energjitike të rinovueshme p.sh ato me titull të thjeshtuar ose jo të fikur biomasa të lengeta dhe të ngurta, energji fotovoltaike, eolike, moto valesuese të baticave, hidro elektrike dhe çdo lloj burimi tjetër energjistik të mundshëm të percaktuara si të rinovueshme nga legjislacioni kombëtar dhe i komunitetit;

Blerja dhe shitja e energjisë elektrike dhe termike autoprodhuar dhe / ose prodhuar nga të tretë në Shqipëri dhe jashtë shtetit;

Blerja dhe shitja e Certifikatave jeshile (CV) dhe formave te tjera te stimulimit mbi prodhimin dhe shitjen e energjise elektrike dhe termike te rinovueshme
Zbulimin dhe tregetimin e mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme per tju nenshtruar perpunimit te lendes dhe / ose energjise;
Kryerja e sherbimeve per ambientin qe konsistojne ne bonifikimin ambiental, dizifektimin, trajtimin e mbetjeve te mbedhura edhe per qellim energjitik, analiza kimike dhe ambientale, kontroll te leshimit ne atmosfere dhe monitorim.
Projektim te integruar, realizim dhe administrim i impianteve te prodhimit te energjise elektrike dhe termike nga burime energjitike konvencionale dhe te rinovueshme per llogari te vetes se tij apo per te trete;
Mirembajtje te impianteve nga te cilat ne radhe te pare per llogari te vetes se tij.
Konsulence e finalizuar me themelimin e joint venture dhe raporteve te ortakerise tregetare dhe prodhuese ndermjet ndermarjeve te perfshira ne te gjitha format e shkembimit tregetar
Aktivitete ne promovimin dhe zhvillimin e pasurive te paluajtshme ne sektorin turistik – rezidencial.
Ajo mund te kryej te gjitha operacionet tregetare, industriale, financiare, mobiliare dhe imobiliare qe Administrata do te vleresoj si te nevojshme dhe / ose te dobishem per arritjen e objektit te shoqerise, si dhe te jape fidejusione, dhe garanzi ne pergjithesi dhe reale, per detyrime te marra edhe nga te trete, dhe te marre interesime dhe pjesmarrje dhe aksionare, ne shoqeri ose ndermarrje te tjera qe kane objekt te ngjashem, ose qe kane lidhje me te.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.



KREU II KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 lekë dhe eshte i ndare në 100 pjesë të barabarta, vlera nominale e të cilave eshte 1000 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te hollanga ortakët e shoqerise perkatesisht :



1. Ital Green Engineering shpk.; kuota me vlere te pergjithshme 50.000 Leke, qe perbejne 50% te kapitalit te shoqerise,
2. Biopower Consulting shpk. kuota me vlere te pergjithshme 45.000 Leke, qe perbejne 45% te kapitalit te shoqerise,
3. Hastriz Sojli. kuota me vlere te pergjithshme 5.000 Leke, qe perbejne 5% te kapitalit te shoqerise,

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

Secili nga ortakët ka te drejte te bleje kuoten e pjesmarrjes ne shoqeri qe ortaku tjeter (ketej e me poshte i quajtur dhenesi) ka nder mend te jape me tituj detyrimi ose gratis,

Dhenesi duhet tju komunikojte ortakeve te tjere, ne adresen qe rezulton ne librin e ortakeve, synimin per te dhene kuotat e tij, duke treguar pranuesin dhe modalitetet e negocimit te transferimit. Brenda 30 diteve nga marrja e ketij komunikimi, ortakët duhet te dergojne nje komunikim dhenesit duke deklaruar se duan te blejne te tere kuoten, objekt i transferimit. Ne mungese, kuota mund ti transferohet pranuesit. Nese me shume ortake deklarojne se duan te blejne, ata duhet te behen bleres te kuotave ne fjale, ne proporzion me kuotat qe ata kane ne shoqeri. Ne komunikimin qe do ti bejne dhenesit, ortakët qe duan te blejne kuotat do te kene te drejten per te paraqitur afatin brenda te cilit do te procedojne per blerjen e pjesmarrjes shoqerore. Ky afat nuk mund te jete me i madh se 3 muaj nga data qe i eshte derguar komunikimi dhenesit.



Me qellim ushtrimin e te drejtes se blerjes, cmimi percaktohet ne baze te situates pasurore te shoqerise, rendimentit te saj, vleres se te mirave materiale dhe jo materiale ne pronesi te saj si dhe cdo rrethane apo kushti qe merret ne konsiderate per te percaktuar vleren e pjesemarrjes shoqerore. Ne mungese te nje marreveshje mbi cmimin ne baze te ketij kriteri, ai do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga Gjykata e qytetit ne te cilen shoqeria ka seline.

Te gjitha komunikimet si me siper duhet te behen me leter rekomande ose te dorezuar ne dore dhe te kunderfirmosura.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU III



ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratorët.

Vendimet merren pas konsultimit me shkrim të ortakëve, në rast se ortakët miratojnë me shkrim përmbajtjen e konsultimit.

Ortakët lajmërohen me letër rekomande të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë.

Në këtë letër njoftohet rendi i ditës.

Lajmërimi bëhet nga administratori ose, në mungesë të tij, nga ekspertë kontabël i autorizuar, po qe se ka të tillë.

Secili ortak mund të kërkojë ligjërisht caktimin e një mandatmbajtësi të ngarkuar për thirrjen e asamblesë dhe caktimin e rendit të ditës.

Asamblea do te jete e vlefshme edhe pse nuk eshte mbledhur ne peputhje me dispoitat si me siper nese ne marrjen e vendimit perkates te kete marre pjese i gjithe kapitali shoqeror dhe te gjithe adminsitratoret apo sindakalistet, nese jane emeruar, te jene te pranishem ose te informuar per mbledhjen dhe asnje nuk kundershton trajtimin e argumentit.

Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Secili ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër.

Ai mund të përfaqësohet edhe nga një tjetër person, nepermjet prokures.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit (si transferimi i kapitalit, zmadhimi i kapitalit shoqeror, financimet etj,) duhet detyrimisht te vendosen me miratimin e ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyquar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakeve, vetem me miratimin e ortakeve qe perfaqesojne jo me pak se 51 % te kapitalit.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve

Ortakët vendosirë për sistemin e administrimit dhe në rastin e një organi administrativ me shumë administratorë, përcaktojnë numrin dhe kompetencat e tyre.

Administratori/administratorët, mund të jenë ose jo ortakë të shoqërisë.

Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë.

Administratori i shoqërisë është z. **Giuseppe LAGROTTA**, lindur në Potenza, me datë 14.04.1973, banor në Bari, Itali në Via de Gasperi 292/D- shtetas italian, madhor me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtes i pasaportës me nr. AK 3684417.

Administratori i shoqërisë emërohet në këto detyra dhe ka kompetencat për një periudhë të përcaktuar deri në revokimin e saj.

Neni 11

Kompetencat

Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm. Administratorët janë të pajisur me kompetencat me të gjera për menaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të atyre operacioneve kur në ligj ose nëpërmjet këtij statuti i është rezervuar vendimeve të ortakëve.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, vec e vec ose së bashku, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.



Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu të drejtë të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e për llogari të Shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qirasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë aktet e themelimit të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajë e hartojë çdo dokument e të kryejë në emër të Shoqërisë çdo veprim përballë të gjitha Bankave shqiptare apo të huaja në lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse të Shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e Shoqërisë si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumë nga këto llogari pa limit.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Neni 12



Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar sic mund te jene :

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarreshjet

Per mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 16


Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare

“ BIOPOWER GREEN ENERGY “ shpk, dhe nenshkuhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale, ne prani te perkthyeses J. Lleshi autenticiteti i të cilave vertetohet nga une Noteri.


ORTAKET

GIUSEPPE LA GROTTA
PER BIOWPOWER CONSULTING SRL


GIUSEPPE LA GROTTA
PER ITAL GREEN ENGINEERING SRL


NOTERE


Notaro
Hajlinda Lleshi
TEL 3554234555



Translated by
Hajlinda Lleshi
